



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:280008

Datë: 26.10.2022

Numri i dokumentit: 03574005

C.nr.371/2019

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtari **Besmir Juniku**, me bashkëpunëtorin profesional Samir Morina, në çështjen juridike të paditëses K. K. për D. dhe F.me E. E. Sh.A. (K.) me seli në Prishtinë, kundër të paditurit B. Z. K. nga fshati Gexhë, Komuna e Rahovecit, për kompensimin e dëmit, vlera e kontestit **222,15 Euro**, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë **26.10.2022** merr këtë:

A K T G J Y K I M **PËR SHKAK TË PADËGJUESHMËRISË (MOSBINDJES)**

APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses K. K. për D. dhe F. me E. E. Sh.A., (K.) me seli në Prishtinë, ashtu që **DETYROHET** i padituri B. Z. K. nga fshati Gexhë, Komuna e Rahovecit, që në emër të kompensimit të dëmit t'ia paguaj paditëses shumën prej **222,15 Euro** (dyqind e njëzet e dy euro e pesëmbëdhjetë cent), me kamatën ligjore **8%** në vit, e cila fillon të rrjedhë nga data 26.09.2019 (data e ushtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, si dhe në emër shpenzimeve procedurale shumën prej **20,00** (njëzetë) **Euro**, të gjitha këto në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësja K. K. për D. dhe F. me E. E. Sh.A. (K.) me seli në Prishtinë, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit B. (Z.) K. nga fshati Gexhë, Komuna e Rahovecit, për shkak të kompensimit të dëmit material në vlerën prej 222,15 Euro.

Në kuptim të nenit 394 të Ligjit për Procedurën Kontestimore gjykata me Aktvendim C.nr.371/2019 të datës 25.07.2022 e ka obliguar të paditurin që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh të jap përgjigje në padi, në të cilën duhet të deklarohet nëse e pranon apo e kundërshton kërkesëpadinë e paditëses, të paraqes faktet dhe provat që e vërtetojnë kundërshtimin e tij. Nga shkresat e lëndës rezulton se Aktvendimi C.nr.371/2019 të datës 25.07.2022, nga pala e paditur

është pranuar me datë 11.08.2022 dhe gjerë më tani i padituri nuk ka parashtruar përgjigje në padi edhe pse gjykata me aktvendim për përgjigjen në padi i ka tërhequr vërejtjen se në rast të mos veprimit sipas këtij aktvendimi do të përballet me pasojat ligjore.

Gjykata me shikimin në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gjakovë - Dega në Rahovec P.nr.146/2015 të datës 06.06.2016, i cili ka marrë formën e prerë me datë 30.06.2016, vërtetoi faktin se paditësi prej datës së pavërtetuar e deri me datë 17.09.2014, në shtëpinë e tij në fshatin Gexhë, Komuna e Rahovecit, ka bërë keqpërdorim të energjisë elektrike duke i shkaktuar të paditurës dëm në vlerën prej 222,15 Euro, e që për këto veprime është shpallur fajtor dhe është dënuar nga gjykata për shkak të kryerjes së veprës penale nga neni 321 të KPRK-së.

Gjykata me shikimin në provën Faturë DGJ14HP03990, të lëshuar nga K., me datë 07.10.2014, të cilës ia dha besimin e plotë, e vërtetoi se lartësia e dëmit me vepër penale (rikthimi i humbjeve të energjisë) është shuma prej 222,15 Euro.

Sipas nenit 136 par. 1 dhe 3 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të datës 19.06.2012 (i cili është në fuqi nga data 20.12.2012), në mënyrë shprehimore është paraparë se *“1. Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, me çka rezulton se i padituri është i detyruar që t’ia kompensojë palës paditëse vlerën e kërkesëpadisë së bashku me shpenzimet tjera aksesore.

Gjykata është e lidhur me aktgjykimin e procedurës penale, konform nenit 14 të LPK-së, i cili e përcakton se: *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”*.

Në bazë të provave të potencuara të cilave gjykata ua dha besimin e plotë, është vërtetuar themelësia dhe lartësia e kërkesëpadisë.

Meqenëse i padituri brenda afatit të përcaktuar me ligj nuk i ka paraqitur gjykatës përgjigje në padi, andaj duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 150 paragraf 1 të LPK-së, gjykata mori këtë aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë (mosbindjes), ndonëse janë plotësuar kushtet siç më poshtë vijojnë:

- a) Të paditurit i është dorëzuar në mënyrë të rregullt padia, provat materiale dhe aktvendimi për dhënien e përgjigjes në padi;
- b) Themelësia e kërkesëpadisë rezulton nga faktet e treguara në padi, dhe
- c) Faktet mbi të cilat mbështetet kërkesë - padia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi.

Andaj, në kuptim të nenit 14, nenit 160 paragraf 6 të Ligjit për Procedurën Kontestimore janë dhënë vetëm arsyet e sipërcituara që e justifikojnë marrjen e këtij Aktgjykimi.

Gjykata ka vendosur lidhur me kamatën ligjore prej 8% konform nenit 382 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u vendos komform nenit 452 paragraf 1 të LPK-së, me ç’rast palës paditëse i janë pranuar shpenzimet në emër të taksave gjyqësore shumë prej 20.00 (njëzetë) Euro, pasi që gjykata ka prova që të njëjtat janë paguar nga paditësja.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil,
C.nr.371/2019, me datë 26.10.2022.**

**B. Profesional
Samir Morina**

**Gj y q t a r i
Besmir Juniku**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa paraqitet nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës - Divizioni Civil në Prishtinë.